



FOKUS I  
*Albania - Kosova*

**Seria A**  
**Përqëndrohuni te**  
**Jezusi - Manuali**



# FOKUSI – Seri A - Manuali

## Përqëndrohuni te Jezusi

### Hyrje

Mirësevini në takimet e "Fokusit". Në këtë seri do të gjeni 5 tema. "FOKUSI" përdor katër shtylla për të strukturuar takimet. Çdo takim përbëhet nga disa elemente fikse, të cilat janë si më poshtë:



#### a. Studimi i Biblës

Së pari, ne duam të dëgjojmë Fjalën e Perëndisë duke studiuar së bashku një pjesë të Biblës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me njohurinë dhe kuptimin më të mirë të asaj që shkruhet dhe çfarë do të thotë, por edhe për mënyrën se si mund ta zbatojmë atë në jetën tonë. Dhe si përshtatet kjo pjesë e Biblës me përvojat tona.



#### b. Lutje

Lutja është themeli i gjithë serive të Fokusit. Duke u varur tek Perëndia, ne duam të arrijmë atë që Zoti mund të bëjë në mesin tonë dhe si Ai mund të punojë përmes nesh. Prandaj, ne duam të lutemi për bekimin e tij, ta falënderojmë dhe ta adhurojmë. Në të njëjtën kohë ne duam të ndërmjetësojmë për njerëzit dhe situatat që po kalojnë.





### c. Në lëvizje

Është e rëndësishme të zbatojmë gjërat që do të mësojmë dhe zbulojmë në këto takime. Në këtë pjesë, propozohen hapa të vegjël që mund të bëjmë si një ushtrim në situatën tonë. Ndonjëherë personalisht, ndonjëherë si grup ose si kishë, ne do të inkurajojmë njëri-tjetrin që me të vërtetë ti zhvillojmë ato aktivitete duke bërë plane konkrete dhe më vonë duke pyetur njëri-tjetrin se si i kemi praktikuar ato plane.



### d. Ndarja e tregimeve

Në seksionin "Ndarja e tregimeve", ju jeni të ftuar të shprehni mendimet tuaja për Zotin dhe besimin dhe t'i ndani me të tjerët. Për më tepër, njerëz nga vende të ndryshme do të flasin për temat në video të shkurtra. Ata përpiqen të ecin me Perëndinë në rrethana të ndryshme, por të gjithë kanë pyetje dhe situata të ngjashme si ju.

## “Fokusi” është një proces shpirtëror

Ky material për grupet është pjesë e serisë “Fokusi”, e cila ka për qëllim të fillojë një proces reflektimi për të gjithë kishën se si mund të jemi një kishë misionare me një përqendrim të përtërirë në Jezus Krishtin. Kjo seri e “Fokusit” është si një rrugë që ecim së bashku. Gjithsej janë gjashtë seri.

“Fokusi” është një proces mësimi i cili ka për qëllim të inkurajojë dy lëvizje:



- a. Një lëvizje në drejtim të brendësisë, drejt zemrës së kishës dhe drejt zemrës sonë personale. Ne do të flasim në thellësi se kush është Zoti në jetën tonë. Ne gjithashtu do të flasim për kuptimin e njohjes së Jezusit dhe të jetuarit me të. Si mund të jemi dëshmitarë besnikë në ditën e sotme? Kjo është një pyetje në radhë të parë për besimin tonë personal. Si mund ta lidhim besimin tonë në jetën tonë të përditshme: me punën tonë, me familjen tonë, me lagjen tonë, me miqtë tanë. Praktikisht: si mund ta lidhim besimin tonë në vendin dhe rolin që Zoti na ka caktuar.



- b. Lëvizja e dytë ka të bëjë me një lëvizje të përtërirë drejt të jashtmes. Ne i hapim sytë, zemrat tona dhe jetën tonë për njerëzit përreth nesh. Sidomos për njerëzit që ende nuk e njohin Jezusin. Ne do të kërkojmë këtë lëvizje të jashtme që nga fillimi i kësaj serie “Fokusi”. Në secilin mësim do të kërkojmë sesi mund të jemi të përfshirë në mënyrë praktike dhe aktive, kështu që nuk do të jetë thjesht një reflektim dhe diskutim i pafund.



## Sfondi

Qëllimi i serisë “Fokusi” është të mbështesë kishat në thirrjen e tyre misionare. Materiale të ndryshme janë zhvilluar duke dëgjuar me kujdes pyetjet e shumë të krishterëve dhe kishave.

Seria “Fokusi” nuk është vetëm një metodë, një strategji apo një program. Është para së gjithash një proces shpirtëror, një proces reflektimi, thellimi dhe ndryshimi.

Ne ndjekim **disa vlera kryesore** që shpjegojnë se çfarë është e rëndësishme në serinë "Fokusi":

### A. Kërkimi dhe përulësia

Procesi fillon duke parë me ndershmëri situatën në veten tonë. Shpesh ne jemi të pasigurt në lidhje me sfidën e madhe të kishës për të qenë një kishë misionare në një shoqëri laike. Sekularizmi dhe mosinteresimi për besim nuk është vetëm diçka jashtë nesh por ndikon edhe në jetën tonë dhe zemrat tona si të krishterë. Ka shumë besimtarë që janë shumë të rregullt me pjesëmarrjen në mbledhjet e kishave, por në zemrat e tyre nuk janë shumë seriozë me besimin e tyre. Kjo mund të na bëjë të ndihemi të pasigurt dhe të përlur. Kur flasim në serinë "Fokusi" për ndryshimin, ne flasim në radhë të parë për ndryshimin në jetën tonë. Është e nevojshme që së pari të përulemi para Zotit, që të jemi të sinqertë me veten tonë, pasiguritë tona dhe pamundësitë tona.

Ne mund t'i kapërcejmë këto probleme vetëm duke kuptuar se sa jemi të varur tek hiri i Zotit. *“Në qoftë se populli im, i cili thirret me emrin tim, përulet, lutet, kërkon fytyrën time dhe kthehet prapa nga rrugët e këqija, unë do ta dëgjoj nga qielli, do t'i fal mëkatën e tij dhe do ta shëroj vendin e tij”.* (2 Kronikave 7:14)



## B. Dëshira dhe pritja

Ne nuk duam të përqendrohemi në situatën aktuale ose ta pranojmë atë. Ne besojmë se dëshira për ndryshim dhe përtëritje vendoset në zemrat tona nga Fryma e Zotit. Ne besojmë në thirrjen e lartë që Zoti ka për kishën e tij. Kur dëshira përzihet me besimin, lind një qëndrim i pritjes. Ne nuk e presim atë nga angazhimi ynë, nga njohuritë ose veprimtaritë tona, por ne e presim atë vetëm nga Ai që na dërgon me fjalët: *"Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë ... dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës"*. (Mateu 28: 19,20). Fillon me të jetuarit në praninë e tij dhe besimi se asgjë nuk është e pamundur për Të.

## C. Përbushja dhe rinovimi

Në Dhiatën e Re misioni nuk është vetëm një përkushtim, por edhe një premtim: *"Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut"* (Veprat 1: 8) Ne besojmë se dëshmia jonë do të sjellë fryte dhe se ndryshimi i vërtetë është i mundur vetëm përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë, i cili na mbush dhe rinovon jetën tonë nga brenda. Në serinë "Fokusi" ne duam të kemi shumë kohe për lutje dhe duam të përqendrohemi në atë që vetë Zoti dëshiron të bëjë në ne dhe përmes nesh përmes Frymës së Tij.

## D. Thellimi dhe zgjerimi

Kur ne mendojmë për ungjillëzimin dhe një kishë misionare mendohen shpejt për modelet, metodat dhe aktivitetet e reja. Por ne besojmë se së pari duhet thellimi shpirtëror. Bëhet fjalë për zemrën tonë, besimin tonë, jetën tonë. Kush është Jezus Krishti për ne dhe si e jetojmë jetën tonë me Të? A i bëjmë gjërat tona gjatë javës, apo vërtet përpiqemi të imitojmë Krishtin në jetën tonë?



Përveç këtij thellimi shpirtëror, zgjerimi është gjithashtu i nevojshëm, në mënyrë që diskutimi për dishepullizimin dhe mënyrën e jetesës misionare të mos kufizohet në një grup të vogël anëtarësh të kishës, por që e gjithë kisha të përfshihet.

## **Pika të vëmendjes për një bisedë të mirë**

### **Të gjithë marrin pjesë dhe mund të flasin**

Një bisedë e mirë fillon me të dëgjuar. Mundohuni së bashku të siguroheni që të gjithë në grup mund të flasin dhe që të gjithë të dëgjojnë.

### **Roli i drejtuesit të bisedës**

Drejtuesi i bisedës nuk është eksperti i cili duhet t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve ose të përcaktojë nëse përgjigjet janë të drejta ose të gabuara. Ai / ajo është atje për të bërë bisedën dhe, nëse është e nevojshme, për ta thelluar atë. Ai / ajo gjithashtu monitoron kohën dhe ndihmon grupin të vazhdojë diskutimin.

### **Pyetje personale**

Shumë nga pyetjet në këtë material nuk janë pyetje diturie, të cilave mund t'i jepet vetëm një përgjigje e saktë. Shumica e pyetjeve janë krijuar për të filluar një bisedë se çfarë do të thotë teksti i Biblës në situatën tonë personale. Pyetjet na ndihmojnë të zbatojmë Biblën në jetën tonë. Ne mund të ndihmojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin në këtë.



### **Dëgjimi i njëri-tjetrit dhe Zotit**



Përveçse duam të dëgjojmë njëri-tjetrin, ne natyrisht duam të dëgjojmë atë që Zoti dëshiron të na tregojë përmes Biblës dhe përmes Frymës të Tij. Për këtë arsye, ne i japim shumë prioritet lutjes. Le të marrim kohë të mjaftueshme për t'u lutur gjatë takimit.

### **Në lëvizje**

Pjesa "Në lëvizje" është një pjesë e rëndësishme sepse është si një urë lidhëse midis asaj që diskutojmë në Bibël dhe praktikës në jetën tonë të përditshme. Jemi të inkurajuar të marrim hapa konkret. Ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin duke bërë plane sa më konkrete të jetë e mundur. Mos pyetni vetëm njëri-tjetrin se çfarë dëshironi të bëni, por edhe konkretisht: Ku, me kë, kur dhe si?

### **Ndarja e tregimeve**

Seksioni "Ndarja e tregimeve" është krijuar për të zbuluar se si Zoti i angazhon njerëzit dhe punon përmes tyre. Ne e bëjmë këtë duke dëgjuar tregimet e të krishterëve të tjerë, të cilët mund të jetojnë afër ose larg. Por edhe duke i thënë njëri-tjetrit se çfarë përvojash kemi me kryerjen e ushtrimeve nga seksioni "Në lëvizje". Është e rëndësishme që të dëgjojmë tregimin e personit tjetër, pa dhënë menjëherë komente ose këshilla të padëshiruara.

### **Kthehu te thelbi**

Qëllimi i këtij materiali diskutimi është që të bashkohemi në një fokus të ri. Një fokus të ri në Jezus Krishtin. Mundohuni të ktheheni përsëri në këtë thelb përsëri, kur largoheni gjatë bisedës, ose kur futeni në diskutime rreth çështjeve dytësore.





### **Konfidencialiteti**

Jini të kujdesshëm me informacionin që dëgjoni nga njëri-tjetri. Sa më personale të bëhet biseda, aq më e vlefshme është. Por nëse i thoni gjërat personale, kjo ju bën gjithashtu të prekshëm. Prandaj, është e nevojshme një atmosferë e sigurt në të cilën të gjithë vlerësohen dhe besimi nuk tradhohet.



### **Atmosferë e mirë**

Krijoni një atmosferë të mirë dhe të rehatshme. Bisedat zhvillohen në kishën e Krishtit. Kjo gjithashtu do të thotë që ne e kuptojmë se jo të gjithë janë njësoj por Perëndia mund të punojë në njerëz të ndryshëm në mënyra shumë të ndryshme. Mahnituni me atë që ju jep Zoti. Ne e kuptojmë se në bisedat tona dhe detyrat konkrete që bëjmë, ne jemi plotësisht të varur nga Fryma e Zotit. Ai madje punon përmes pafuqisë sonë.

### **Lutje**

Lutja është një pjesë e rëndësishme e “Fokusit”. Ne besojmë se një seri e “Fokusit” ka vetëm kuptim nëse ajo zhvillohet me lutje. A doni të luteni për procesin e “Fokusit” në kishën tuaj? Më poshtë janë disa sugjerime lutjeje që mund të përdorni në grup ose në shtëpi.

### **Përrulje**

Në procesin e “Fokusit” është e rëndësishme të kërkonit falje. Ne duhet të jemi të sinqertë me Perëndinë dhe t'i tregojmë atij për vaktësinë tonë, ndrojtjen tonë, paaftësinë tonë dhe fajin tonë. Gjithë këto gjera janë në zemrat tona. Përmendini këto në lutje dhe kërkojini Zotit falje.



### **Lutje**

- Lutuni për programin “Fokusi” në kishë. Kërkojini Zotit të bekojë procesin. Mendoni për atë që dëshironi për procesin e “Fokusit”. Çfarë doni të ndodhë me veten tuaj? Po me kishën? Shprehe këtë dëshirë tek Zoti.
- Lutuni për udhëheqësin e kishës dhe udhëheqësit e tjerë dhe rolin e tyre në proces.
- Lutuni për pjesëmarrësit në serinë “Fokusi”.
- Lutuni që Zoti të bekojë bisedat dhe t'i ndihmojë pjesëmarrësit të praktikojnë atë që mësojnë.
- Lutuni për anëtarët e Kishës dhe kërkoni nga Zoti që të kenë një takim të ri me Jezusin.
- Lutuni për njerëzit që takoni në jetën e përditshme që nuk e njohin Zotin akoma. Lutuni që ata të njihen me Jezus Krishtin.

### **Falënderime**

- Falënderoni Zotin për Atë që është dhe për çfarë Ai ka bërë për ne.
- Falënderoni Zotin për këtë seri “Fokusi” në kishën tuaj.
- Falënderoni Zotin për kishën në të cilën jeni anëtar.



## Tema e parë:

# Kush jemi ne?



1. **Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.

2. **Lexoni faqet 2, 3, dhe 4.**



3. **Diskutoni së bashku pyetjen 1.**

Përgjigjet e mundshme janë: Studimi i Biblës, lutja së bashku, dhënia e një shembulli të mirë, inkurajimi ose korrigjimi i njërit-tjetrit, takimet në kishë, lutja për njëri-tjetrin etj.

4. **Vazhdoni të lexoni faqen 5.**



5. **Diskutoni së bashku pyetjen 2.**

Përgjigjet e mundshme: Në punë (por kjo nuk lejohet kudo), në shkollë, në lagjen tuaj ose me familjen tuaj. Ndonjëherë jo vetëm me fjalë, por edhe me sjelljen tuaj mund të tregoni diçka nga besimi juaj i krishterë.



6. **Lexoni historinë biblike të Lukës 10:38 në faqen 5.**

Nëse keni mundësi, mund të shfaqni videon e shkurtër të kësaj historie biblike. Skanoni kodin QR ose shkonin te <https://youtu.be/1UR7Yoh4GWo>



7. **Pastaj lexoni tekstin në faqen 6.**



8. **Flisni me grupin në lidhje me pyetjen 3.**

Kjo bisedë mund të bëhet në grupe të vogla. Më pas mund t'i shpjegoni grupit të madh se të qenit i zënë nuk është gjithmonë



një gjë e keqe. Ndonjëherë gjërat duhet të bëhen për shembull gjëra praktike në kishë: Organizimi i karrigeve, pastrimi, organizimi i aktiviteteve. Kjo duhet të ndodhë. Është mirë që ka "Marta" që duan ta bëjnë këtë. Por këto aktivitete nuk duhet të na pengojnë kurrë që të mos dëgjojmë më Jezusin ose Biblën. Këto mbeten më të rëndësishmet. Ndonjëherë duhet të ndalemi për një moment dhe të pyesim veten: Me çfarë jam kaq i zënë? A do të arrij ndonjëherë të dëgjoj Jezusin?

### 9. Lexoni faqen 6 “Karakterit dhe talenti”.

Ju mund të shpjegoni diçka rreth dhjakëve. Në disa kisha ungjillore kanë dhjakë, por disa të tjera jo. Dhjakët janë njerëzit të cilët kujdesen për çështjet praktike. (Jo në kishat katolike romake ku janë përgjegjëse për liturgjinë e kishës). Në kishat ku nuk ka dhjakë, pleqtë shpesh e marrin këtë përgjegjësi ose një grup anëtarësh të kishës.



### 10. Diskutoni së bashku pyetjen 4.

Është interesante të shihet se si është organizuar kjo në kishën tuaj. A mund të jetë ndryshe? Mendoni për adhurimin kryesor, predikimin, punën e fëmijëve, pastrimin, etj. Vini në dukje se nuk është mirë nëse gjithçka bëhet nga 1 ose 2 persona. Këta njerëz mund të sëmuren ose duhet të udhëtojnë. Atëherë është mirë nëse të tjerët mund ti bashkohen e të jenë disa persona në një shërbesë të caktuar, për të ndihmuar njëri tjetrin.

### 11. Lexoni faqen 7 dhe 8 “Ndjenjë detyrë”.

Mund të pyesni: A kanë shembuj të ndryshimit të kulturës në Shqipëri, ku mikpritja ka rënë?





## 12. Vazhdoni me leximin e faqes 8 “Jemi kaq të zënë.

## 13. Pyesni njerëzit nëse e dinë se çfarë do të thotë individualizmi.

Individualizmi vjen nga fjala “individu”, që do të thotë "vetë". Individualizmi thekson se çdo person është personalisht i rëndësishëm dhe se ju duhet të përpiqeni të qëndroni në këmbë për veten tuaj. Mund të jepni shembuj të kulturave të ndryshme:

- Në kulturat **perëndimore** ndodh ndonjëherë që askush të mos e di se kush është fqinji i tij në një kompleks të madh apartamentesh. Ndonjëherë ka ndodhur se një fqinj të vdesë dhe askush të mos jetë në dijeni, sepse qiranë, ujin dhe dritat i paguan banka automatikisht. Kjo është një shembull për një shoqëri shumë individualiste.
- **Njerëzit e Afrikës** janë shumë ndryshe. Ata kanë një kulturë ku bëjnë gjithçka së bashku. Ata jetojnë shpesh në një komunë, me vëllezër dhe motra, gra, prindër dhe fëmijë së bashku. Kur njëri prej tyre është i suksesshëm financiarisht, ai pritët të ndajë pasurinë e tij. Ai duhet të pranojë se përndryshe do të braktiset dhe do të mbetet vetëm. Ai nuk mund të rrezikojë që në rast se sëmuret ose ka nevojë për familjen e tij ai do të jetë vetë.
- Po kultura shqiptare si është? Diku në mes?

## 14. Lexoni faqen 8 “Vendi i duhur”.



## 15. Diskutoni (në grupe të vogla nesë ka kohë) pyetjen 5, faqja 9.



## 16. Vazhdoni me leximin e faqes 9 “Takim me Jezusin”.



### 17. Diskutoni pyetjen 6 në faqen 10.

A gjejmë kohë për të qenë në këmbët e Jezusit?

- Çfarë zakoni kemi në leximin e Biblës? Çdo ditë, apo jo? Në mëngjes ose në darkë?
- Cila është një kohë e mirë për ne?
- A përdorim një metodë apo kalendar apo thjesht hapim Biblën?

Dëgjimi i muzikës ose audios së krishterë është gjithashtu i dobishëm, por fjalët e Biblës janë më të fuqishme se thjesht muzika ose meditimet.

- Në Holandë shumë të krishterë kanë zakon të lexojnë si familje një pjesë të Biblës pas ngrënies.



### 18. Mbylleni takimin me një lutje.



Tema e dytë:

## Mahnitje



1. **Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.
2. **Kujtojeni njerëzve se herën e fundit folëm për arsyet pse ndonjëherë nuk jemi " të ulur te këmbët e Jezusit".**  
Ndonjëherë gjërat në jetën tonë ose në kishë nuk janë aq të mira sa supozohet të jenë. Sot do të flasim për gjërat në kishë me të cilat jemi të kënaqur. Perëndia na ka bekuar ne dhe kishën tonë me shumë gjëra dhe do ti ndajmë këto bekime gjatë këtij takimi.
3. **Lexoni shpjegimin në faqen 11.**



4. **Vazhdoni me leximin e Filipianëve 1:3-11 në faqen 12.**



5. **Diskutoni për pyetjen 1 në faqen 13.**  
Cilat janë fjalët e rëndësishme në këtë pasazh biblik? Merrni pak kohë për t'i lënë njerëzit ta lexojnë përsëri. Përgjigjet e mundshme janë:
  - a. Pali është falënderues;
  - b. Ai i mban njerëzit në zemër;
  - c. Ai falënderon Zotin për ta;
  - d. Ai lutet për ta;
  - e. Ai beson se Zoti, i cili ka nisur një punë të mirë në to, do ta përfundojë deri në fund.

6. **Lexoni tekstin në faqen 13 për Palin dhe kishën në Filipi.**

Tregoni diçka rreth Palit dhe kishës së Filipisë:

- a. Pali ishte fillimisht një besimtar jude (farise). Kishte studiuar



- shumë. Ai persekutoi ndjekësit e Jezusit.
- b. Pasi të krishterët ikën nga Jeruzalemi dhe shkuan në qytete të tjera, Pali i ndoqi ata dhe shkoi në Damask.
  - c. Rrugës për në Damask ai pa një vegim të Jezusit, i cili e pyeti pse e persekutonte. Pali u verbua. Shokët e tij e sollën në Damask dhe ai pa një ëndërr që i tha të priste Barnabën.
  - d. Edhe Barnaba (i krishterë në Damask) pa një ëndërr që i tha të shkonte te Pali. Barnaba shkoi te Pali, megjithëse ai duhet të ketë pasur shumë frikë.
  - e. Barnaba u lut për Palin dhe ai mundi të shihte përsëri. Pali u pagëzua dhe më vonë u bë një i krishterë i fortë.
  - f. Pali u bë një prej misionarëve më të suksesshëm. Ai shkoi në shumë vende dhe themeloi kisha. Ai nuk qëndroi për shumë kohë në një kishë, por udhëtoi në shumë vende.
  - g. Pasi u largua nga kishat e reja, ai mbajti kontakte me ta duke u shkruar letra.
  - h. Kështu ndodhi edhe me kishën në Filipi. Kjo është në të vërtetë letra që lexojmë sot. Ai e kishte themeluar atë kishë 10 vjet më parë kur u shkroi atyre. Është një letër shumë pozitive.



## 7. Lërimi njerëzit të diskutojnë në grupe të vogla pyetjen 2.

Merrni mjaft kohë për këtë pyetje.

Përgjigjet e mundshme janë:

- a. Kisha ka qenë një bekim shpirtërisht (lutja, shpjegimi i Biblës, të mësuarit më shumë për Zotin dhe Jezusin). Kisha ka qenë një bekim materialisht, me pako ushqimore etj. Kisha ka qenë një bekim shoqëror. Është si një familje, që të mos ndihen vetëm.
- b. Ato mund të jenë një bekim për kishën sepse:  
Ndihmojnë në gjërat praktike, pastrimin, shërbesën e fëmijëve etj.  
Ndihmojnë në kujdesin për njerëzit që janë në nevojë ose të vetmuar (duke u lutur, duke telefonuar).  
Disa e kishin të vështirë të përmendnin diçka sepse mendojnë se është mburrje kur e thonë këtë për veten e tyre. Shpjegoni se





Perëndia i ka dhënë secilit prej nesh disa dhurata për t'u përdorur në kishë. Nuk është mburrje kur i përdorim ato dhurata. Do të ishte një turp nëse nuk do t'i përdornim ato talente.

### 8. Vazhdoni të lexoni në faqen 14 “Të lidhur në hir”.

Përmendni këtu se disa njerëz fokusohen vetëm në problemet në kishë. Ata presin që kisha të jetë e përsosur. Por asnjë kishë nuk është e përsosur, sepse të gjitha kishat janë me njerëz që nuk janë të përsosur. Disa njerëz ndryshojnë shpesh nga kisha ose fillojnë kishën e tyre. Më në fund ata do të kuptojnë se nuk ka kishë të përsosur. Kisha është në dorën e Zotit. Ai është kreu i kishës. Kisha është në duart e tij.



### 9. Vazhdoni të lexoni faqen 15 “Mprehtësi”.



### 10. Diskutoni pyetjen 3 Përse jemi ne kishë?

Kjo është një pyetje e bukur për t'u bërë në grupin e madh. Ato mund të kenë shumë përgjigje, por në fakt ka tre tema që janë shumë thelbësore:

- Ne jemi kishë për të **lavdëruar** dhe nderuar Zotin (adhurim, lutje, shërbim etj.)
- Ne jemi kishë për të **rritur** veten në besim dhe njohuri. Të shenjtërohen etj. Të gëzojmë shoqëri me njëri-tjetrin dhe të inkurajojmë njëri-tjetrin. (e brendshme)
- Ne jemi kishë për t'u **shërbyer** të tjerëve. Për t'i shërbyer kësaj bote. Për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për t'u treguar atyre



për ungjillin (ungjilltar) (e jashtme).  
Kujtojuni atyre simbolin në faqen 4 në librin e tyre... Vetëm kur ne si kishë i kemi të tre elementët, jemi një kishë e shëndetshme.



### 11. Bëni pyetjet:

Cili nga tre elementët është shumë i fortë në kishën tonë? Cili element është i dobët apo mungon? Si mund ta ndryshojmë atë?

### 12. Lexoni tekstin nën pyetjen 3 në faqen 15.

Kisha nuk është vetëm për veten e tyre, por edhe për të qenë një bekim për botën.



### 13. Vazhdoni me Tregimin në faqen 16.

Në grupe të vogla nëse ka ende kohë. Si e shihni Perëndinë duke punuar në kishën tuaj? Si e ka përdorur Perëndia kishën për të qenë një bekim për botën?

Përgjigjet e mundshme: Pako ushqimore, ndihma për tërmetin, mësimet angleze etj. Fryma e Shenjtë po e përdor kishën tonë për të qenë një bekim për të tjerët. Le të hapim sytë për këtë. Ndonjëherë ne nuk e shohim atë.

### 14. Kërkoni një ose dy persona të shkruajnë për takimin e ardhshëm diçka për kishën e tyre në stilin e Palit.



### 15. Mbylleni takimin me lutje.



## Tema e tretë: **Dashuria e parë**



1. **Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Herën e fundit kemi biseduar për kishën.**

Si kisha ka qenë një bekim për ne. Disa pjesëmarrës do të përpiqeshin ta shkruanin atë në stilin e Palit. Kush mund ta lexojë këtë?

(Nëse askush nuk ka përgatitur një letër, një letër mund të lexohet nga një kishë tjetër)

- Çfarë vëreni?

(A flitet për vlerën e kishës vetëm për anëtarët, ose edhe për lagjen?)

3. **Vazhdoni me tekstin në faqen 17**

Kisha shpesh është një bekim, por ndonjëherë ka edhe sfida ose probleme. Ndonjëherë mund të pyesni veten: "Si mund të vazhdojmë?"



4. **Ndani disa sfida/ probleme? Pyetje 1, faqe 18.**

Shembuj të problemeve mund të përfshijnë:

- Sfidat financiare;
- Ulja e numrit të anëtarëve të kishës;
- Vështirë për të arritur të rinjtë;
- Konfliktet në Kishë;
- Paragjykim nga njerëzit jashtë kishës, pse shkoni në atë kishë?;
- Mosinteresim, më pak entuziazëm sesa në fillim;
- Emigrimi;

Problemi më i madh për të cilin lexojmë në Bibël është, kur njerëzit lënë "dashurinë tyre të parë".





**5. Lexoni tekstin në faqen 18.**



**6. Do shihni një video të shkurtër (deri në 2:30 min.)**

Skanoni kodin QR, ose shkonin te

<https://youtu.be/NIE6Say9rZ8>

Ne shohim një numër njerëzish që flasin për momentin kur u bënë të krishterë. Dëgjoni me kujdes dhe përmendni me cilin person ngjasoni më shumë.



**7. Diskutoni për këtë pyetje (faqe 18) në grupe të vogla.**

Është e habitshme që shumë përmendën mbi të gjitha:

- Është e rëndësishme që ata ishin të mirëpritur në kishë dhe se kishte dashuri.
- Shumë njerëz ishin bërë të krishterë pas një procesi të gjatë, jo brenda një dite. Disa thanë sa e mrekullueshme ishte kur u bënë të krishterë. Është bukur të marrësh pak kohë për këtë sepse është inkurajuese ta dëgjosh atë nga njëri-tjetri.



**8. Shikoni pjesën e dytë të videos (nga 2:30 deri në 8:00).**

Diskutoni për këtë në grupin e madh.

- Çfarë bie në sy?
- Çfarë mund të themi për dashurinë e parë? Si ishte kjo dhe si ka ndryshuar? Shumë tregojnë se si janë më pak entuziastë sesa në fillim. Kuptohet që kjo mund të ndryshojë. Ne të gjithë jemi njerëz me jetë të zënë etj.



**9. Lexoni pasazhin tek Zbulesa 2: 1-7 në faqen 19.**

Si shpjegim i pasazhit të Biblës mund të përmendni se libri i Zbulesës është shkruar nga Gjoni. Në moshë të re ai ishte “dishepulli të cilin Jezusi e donte”. Tani ai është rreth 80-90 vjeç dhe persekutimi i të krishterëve ka filluar. Gjoni është dëbuar në ishullin Patmos dhe duhet të punojë në miniera. Aty ai mori vizione në pleqëri. Jezusi kishte një mesazh për kishat e Azisë së Vogël (Turqia moderne).



**Pas leximit:** Pyetini ata se çfarë është shandani. Çfarë do të nënkuptohet me "heqjen e shandanit"? (heq dritën) Ky është një rrezik kur ke lënë dashurinë e parë.

Ata kishin braktisur **dashurinë** e parë. Dashuria është ftohur dhe nuk ka më pasion.

### 10. Lexoni faqen 19 dhe 20 “Efesi / Vlerësim”.

Pastaj përmbledheni tekstin. Pali shkruan:

- Ai i lavdëron ata për përpjekjet e tyre të mëdha. Është një kishë aktive;
- Ai tregon këmbënguljen e tyre në rrethana të vështira (diskriminim) Si shpjegim, ju mund të lexoni Veprat e Apostujve 19: 23-41;
- Ai thotë se ata e kanë mbajtur doktrinën e pastër. E vërteta e ungjillit.

### 11. Lexoni faqen 20 “Kritikë”.

Por përveç mirënjohjes, pati edhe kritika nga Pali. Jo gjithçka shkoi mirë.

Të gjitha gjërat e mira që u thanë së pari nuk janë të rëndësishme nëse nuk vijnë nga dashuria. Pra, ekziston një rrezik i madh, po ashtu për këtë kishë. Nëse e lëmë dashurinë e parë, Zoti mund t'i heq shandanin. Ndoshta duhet ta thuash këtë dy herë në mënyrë që njerëzit të kenë kohë të reflektojnë për të.



### 12. Diskutoni pyetjen 2, faqe 21.

- Cilat pika do të përmendte Jezusi nëse do të vlerësonte kishën tonë?
- Cilat pika pozitive do të përmendte ai?
- Çfarë pikash negative? Përgjigjet e mundshme janë:
- shumë pak përfshirje e njerëzve në aktivitete;
- shumë pak dhënie në ofertat;
- shumë pak ungjillëzim, etj.



### 13. Diskutoni pyetjen 3, faqe 21.



Zakonisht nuk ka kohë të mjaftueshme për të mbaruar këtë temë brenda një takimi, prandaj vazhdoni herën tjetër me temën “Dashuria e parë”.

#### 14. Vazhdoni me faqen 21 dhe 22 “Shuaj”

Përsëritëm sesi pamë herën e fundit që të jemi mirënjohës për këtë Kishë. Por në të njëjtën kohë ekziston një rrezik: ne mund të lëmë dashurinë tonë të parë.

Në video pamë që kjo i ndodhi një numri personash nga Hollanda. Pastaj lexuam nga Bibla (Zbulesa) që kjo ndodhi edhe në kishën në Efes.

Rreziku ishte që Zoti do të merrte shandanin.

Kisha në Efes në të vërtetë është zhdukur. Shumë pak kisha kanë mbetur në Turqi sot.

#### 15. Pyetje: A njohim kisha në Shqipëri që janë mbyllur ndërvite?

- Cilat janë arsyet kryesore për këtë?
  - Çfarë mund të mësojmë nga kjo?
  - Shumë njerëz dinin për kishat që janë mbyllur.
- Ndonjëherë arsyeja është shumë praktike, p.sh. që fondet kanë mbaruar, që pastori / misionari është larguar, që anëtarët e kishës kanë emigruar, etj. Por është akoma mirë të theksojmë se kisha ku ju jeni ka gjithmonë rrezik të zhduket nëse nuk jeni të kujdesshëm.



#### 16. Diskutoni pyetjen 4 në faqen 22.

Ndonjëherë ne jemi shumë të ndrojtur kur flasim me të tjerët për besimin tonë. A ndodh kjo sepse ne vetë nuk jemi më aq entuziastë për Jezusin apo jo?

(Nxisni njerëzit t'ju tregojnë se si ata në fillim flisnin për besimin e tyre me të gjithë njerëzit dhe si mund të mos flasin më aq shpesh tani. Gjithashtu përmendni se është shumë normale që jo të krishterët të flasin për gjëra për të cilat janë entuziastë, të tilla si futbolli , telefon i ri, emigrimi, familja e tyre, etj. Ata flasin me entuziazëm për diçka që e shohin të bukur dhe të rëndësishme.



Ne gjithashtu duhet të flasim për besimin tonë në këtë mënyrë, sepse kjo është diçka që ne gjithashtu e shohim të veçantë, apo jo?)

**17. Lexoni faqen 22 “Përqendrohu në Krishtin”.**

Ne përpiqemi të rizbulojmë dashurinë e parë për Jezusin. Ai vetë është në mesin tonë. Ai mban kishën. Kisha i përket Zotit, jo neve. Letra drejtuar Efesit përfundon me një premtim: vargu 7 "Do të jetë përsëri si në parajsën origjinale".



**18. Lexoni faqen 23 "Në lëvizje".**



**19. Mbylleni takimin me lutje.**



Tema e katërt: Dëshirë

## Dëshirë



1. **Mirëprisni njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë.**  
Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Në lëvizje**

Folëm për një aktivitet për të inkurajuar dikë gjatë javës së kaluar: një telefonatë, një vizitë, një lutje ose një mënyrë për të treguar dashurinë e Perëndisë ndaj tij ose asaj. A keni arritur të bëni ndonjë gjë për dikë?

3. **Lexoni faqen 24 "Ndrojtja që ndonjëherë"**



4. **Lexoni Psalmin 63, në faqen 25.**



5. **Diskutoni pyetjen 1, faqe 25.**

- Si flet poeti për dëshirën e tij për Zotin? (etje, uri, dëshira e zjarrtë, mall dhe shumë fjalë të tjera nga teksti)
- Si do ta përshkruanit dëshirën tuaj kur mendoni për marrëdhënien tuaj me Zotin? (Disa e përshkruajnë atë me fjalë nga Psalmi 63, por është gjithashtu mirë nëse ata mund ta përshkruajnë atë me fjalët e tyre. Një përshkrim i bukur është: "Të njohësh Perëndinë gjithnjë e më mirë".

6. **Lexoni faqen 25 dhe 26 "Etje".**

7. **Lexoni faqen 26 "Kujtimet".**



8. **Diskutoni pyetjen 2, faqe 27.**

Cilat kujtime nga e kaluara ju japin shpresë dhe pritje që Zoti dëshiron të jetë me ju sot? (Cilat gjëra nga e kaluara ju kujtojnë kujdesin e Zotit, praninë e Zotit në jetën tuaj),







Disa përmendën kujtime të dhimbshme, të tilla si vdekja e një personi. Madje ajo që ndodhi i hoqi besimin në Zot, por ata tani janë kthyer. Ata gjithashtu mund të përdorin përvojat e tyre për të ndihmuar të tjerët që po përjetojnë momente dyshimi. Përmendni se si këto përvoja të së kaluarës mund të na ndihmojnë të qëndrojmë të fortë nëse problemet na vijnë përsëri. Zoti është me ne.

### 9. Diskutoni pyetjen 3, faqe 27.

Plotëso Fjalinë. "Zot ti je për mua". Për shembull, përgjigjet mund të jenë: Drita, jeta, gjithçka, e ardhmja, falja, shpresa, paqja...

### 10. Lexoni "Shpirti im mbahet", në faqen 27.

Në fund të fundit, kisha nuk na përket neve, një udhëheqësi të kishës, por kisha i përket Vetë Zotit. Ai është kreu i kishës.



### 11. Shihni videon e Luis nga Kolombia.

Skanoni kodin QR ose shkonin te <https://youtu.be/2TAsDyZwLUo>

Ai ka kaluar shumë. Si fëmijë, ai dëgjo për ungjillin në takimin e fëmijëve të Kishës. Pas kësaj, si adoleshent, ai nuk ishte më i interesuar për besimin. Ai përfundimisht bëhet një ushtar. Një luftë civile kishte filluar në Kolumbi. Luis gjithashtu kishte humbur shumë familje në luftë. Ai përdori shumë dhunë.



Derisa një ditë e kuptoi se nuk mund të vazhdonte me këtë. Atij i kujtohet takimi i fëmijëve. Ai shkoi te një pastor dhe bisedoi me të për jetën e tij. Ai përfundimisht u bë i krishterë. Tani Luis ndihmon njerëzit që kanë probleme me drogën.



### 12. Diskutoni pyetjet, në faqen 28.

Përgjigjet e mundshme janë:

- a. Luis është entuziast dhe dëshiron të ndajë besimin e tij me të tjerët.
- b. Ai dëshiron të jetojë jetën e tij me Perëndinë.



### 13. Në lëvizje

Gjeni një këngë / poezi në lidhje me dëshirën tuaj për Zotin. Cila këngë ju flet veçanërisht dhe tregon diçka për dëshirën tuaj për të qenë me Perëndinë? Apo mund ta shkruani këtë dëshirë në një poezi?



### 14. Mbylleni takimin me lutje.



## Tema e pestë: Pritje

# Pritje

- 1. Mirëprisni** njerëzit dhe filloni me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



- 2. Filloni duke diskutuar detyrën e shtëpisë (Në lëvizje) në faqen 29.**

Kjo është një detyrë shumë e bukur, sepse përfshin njerëz që ndonjëherë nuk flasin shumë. Disa kanë shkruar këngën e tyre. Të tjerët përmendin këngë të njohura që u pëlqejnë. Nëse nuk ka kontribut nga kjo kishë, gjithmonë mund të lexoni një këngë ose poezi që ju pëlqen.

- 3. Lexoni faqen 29** Çdonjëri mendon ...



- 4. Vazhdoni me pyetjen 1, në faqen 30.**

Lëri njerëzit të mendojnë për një moment dhe pastaj plotësoni fjalinë.....



- 5. Lexoni tekstin në faqen 30 dhe më pas vargjet biblike nga Isaia 11: 1-10.**



- 6. Diskutoni pyetjen 2, faqe 31.**

- Cilat imazhe shfaqen në këtë histori? (Kafshë të egra me dele / trangu me degëz)
- Cili imazh ju pëlqen dhe pse?

- 7. Lexoni faqen 31 "Konteksti".**

Theksoni se vetë njerëzit e Zotit ishin fajtorë për situatën e krijuar nga pabesia dhe mosbesimi.

Edhe ne si kishë ndonjëherë bëjmë që Zoti të largohet nga ne. Për shkak të kulturës sonë, individualizmit, materializmit, sekularizmit, mungesës së besimit / dashurisë etj.



## 8. Vazhdoni faqen 32 “Fillim i vogël”.

Ka shenja shpresëdhënëse, jetë të re. Shumë i vogël ndonjëherë, shumë i prekshëm.

- A kemi shembuj të gjërave që filluan të vogla dhe u rritën?
- Si e shohim që Zoti është duke vepruar në kishën tonë (ndoshta në gjëra të vogla) Është një pyetje e rëndësishme. Ata mund të përmendën për shembull: këtë takim, faktin që njerëzit vazhdojnë të vijnë pavarësisht problemet, etj.

Pritja jonë për kishën dhe botën bazohet vetëm te Zoti, i cili do të ndërhyjë. Ne nuk mund ta bazojmë pritjen tonë në idenë se gjithçka do të jetë në rregull, që do të jemi në gjendje të rregullojmë gjithçka vetë.



## 9. Diskutoni pyetjen 3, faqe 31 (në grupe të vogla)

- Cilat gjëra shpresëdhënëse që shihni që po ndodhin në kishën tuaj?
- Si shohim që Zoti është duke vepruar në kishën tonë (edhe në gjëra të vogla)  
(Përgjigje e mundshme: Njerëzit vazhdojnë të vijnë në kishë, ka shërbime të këndshme dhe momente të studimit të Biblës, aktivitetet me fëmijët po shkojnë mirë, etj.)

## 10. Lexoni faqen 33 Mesia.

Ky tekst ka të bëjë me Mesian dhe jo vetëm për kohën e Dhiatës së Vjetër, por edhe për ardhjen e Jezusit. Fryma është gjithashtu e përfshirë.



## 11. Diskutoni pyetjen 4, faqe 33.

Ky tekst ka të bëjë me Paqen dhe Drejtësinë.

- Çfarë bëjmë ne si kishë me këto fjalë?
- A po sjellim paqen dhe drejtësinë në fshatin tonë, lagjen tonë?
- Si mund ta bëjmë atë?

Është një pyetje e ndërlikuar. Ndonjëherë ne mund të jemi paqebërës, shumë të vegjël, ose të qëndrojmë për dikë që po trajtohet padrejtësisht. Shembuj të paqes në një situatë



konflikti.

Ka shembuj të njerëzve që përpiqen të veprojnë si pajtues në lagjen ose familjen e tyre. Njerëz që janë kundër korrupsionit dhe nuk marrin pjesë në të, edhe nëse është e vështirë në punë. Pra, nëse jemi të sinqertë dhe gjithashtu duam të sjellim drejtësi dhe paqe, Zoti do të na përdorë.

## 12. Lexoni faqen 33, 34 “Parajsë / Flamur”.

Paqe nëpër botë. Jo vetëm për ne si besimtarë individualë, ose për kishën tonë, por paqe në të gjithë botën. Puna e Zotit po bëhet më e dukshme (flamuri).



## 13. Lutja, lexoni faqen 35.





FOKUSI  
*Albania - Kosova*



[www.fokusi.al](http://www.fokusi.al)



Fokusi



[info@fokusi.al](mailto:info@fokusi.al)



0697013501